




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	DPK
Nr. i faq Broj: strana Nr. pages	02
Nr Prot. Br Prot. Prot No.	03-02/2803/1
Data Datum Date	27-09-2017
PRISHTINE	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 paragrafi 11 dhe 12 të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 26.09.2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-02-2403/17 për z. Xhafer Tahiri – Ish Drejtor i Përgjithshëm në Agjencinë për Pronë Industriale në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë (MTI), për shkak se ai ka dhënë dorëheqje nga kjo pozitë dhe tanimë nuk ushtron asnjë funksion tjetër si Zyrtar i lartë publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur, me nr. protokoli AKK-03-02-2403/17 për Zyrtarin e lartë, z. Xhafer Tahiri, ka qenë një situatë e dyshuar me konflikt interesi për shkak se gjatë kohës së ushtrimit të funksionit publik zyrtarët e lartë nuk kanë të drejtë të ushtrojnë funksion menaxhues në ndërmarrje private.

Agjencia kundër Korrupsionit e ka hapur rastin si rast të dyshuar, por gjatë procesit të hetimit është konstatuar se z. Tahiri fillimisht ka dhënë dorëheqje nga pozita e tij publike (D.P.03/3450/17) dhe pastaj e ka hapur biznesin e tij privat, e që faktikisht në këto rrethana të reja nuk paraqet as lëndë hetimi, sepse përderisa i njëjti nuk ushtron funksion publik, nuk kemi të bëjmë me konflikt interesi.


II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihapë rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit


/ Shaip Havolli /

